

**GJYKATA SUPREME
E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
MBLEDHJA E PËRGJITHSHME**

KODI I ETIKËS SË GJYQTARËVE DHE GJYQTARËVE POROT

Shkup, shtator 2019

KODI I ETIKËS SË GJYQTARËVE DHE GJYQTARËVE POROT



PREAMBULË

Duke marrë parasysh principin themelor të Deklaratës Universale për të drejtat e njerëzve, se secili ka plotësisht të drejtë të barabartë që të dëgjohet publikisht nga ana e gjykatës së paanshme dhe të pavarur, gjatë konstatimit të së drejtave dhe obligimeve dhe sa i përket çfarë do lloji të akuzës penale,

Duke marrë parasysh se Pakti Ndërkombëtar i të drejtave dhe politikave civile garanton se të gjithë personat janë të barabartë në gjykata dhe para drejtësisë dhe se secili ka të drejtë për dëgjim publik, në mënyrë të drejtpërdrejtë nga ana e gjykatës kompetente, të paanshme dhe të pavarur, e themeluar me ligj, që do të vendos edhe për themelimin e cilësdo akuzë të natyrës penale të drejtuar kundër saj, edhe për kontestet për të drejtat dhe obligimet e saj të natyrës juridiko - civile,

Duke marrë parasysh Dokumentin Evropian për statusin e gjyqtarëve, që tregon se gjyqtarët duhet të kenë status që do tu sigurohet paanshmëri në shpërndarjen e drejtë të lëndëve konkrete dhe individuale,

Duke marrë parasysh Mendimin me nr.3 të Këshillit Konsultativ të gjyqtarëve evropian (KKGJE), që udhëzon në mënyrën se si duhet të jenë të formuluarat standartet e sjelljes etike të gjyqtarëve, si dhe rregullat dhe principet etike të sjelljes gjyqësore dhe jep kahje dhe rekomandime të mëtejme për implementimin e tyre në legjislacionet e vendeve – anëtare të Këshillit të Evropës,

Duke marrë parasysh Rekomandimin nr. (94) 12 të Komitetit të ministrave të Këshillit të Evropës për gjyqtarët – pavarësinë, efikasitetin dhe përgjegjësinë të gjyqtarëve, që udhëzon se gjyqtarët në realizimin e aktiviteteve të tyre patjetër duhet të udhëhiqen nga principet etike të sjelljes profesionale,

Duke marrë parasysh rekomandimet e Raportit të Dytë të GREKO, të miratuar në mbledhjen plenare të 80 – të, të 18-22 Qershor 2018, për sinkronizim, që i vlerëson masat që i marrin përsipër autoritetet e Republikës së Maqedonisë së Veriut për zbatimin e rekomandimeve aktuale që janë dhënë në Raportin e rrethit të katërt të evoulimit që ka të bëjë me “Prevenca e korrupsionit sa i përket deputetëve, gjyqtarëve dhe prokurorëve”, në Rekomandimin nr.XI që udhëzon se është i nevojshëm zhvillimi i mekanizmave plotësues, rregullat dhe udhëzuesit e gjyqtarëve sa i përket pranimit të dhuratave, definimit të benefiteve jomateriale dhe përparësi të tjera, si dhe monitorimin përkatës të rregullave të tilla në suaza të Kodit etik të gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë.

Duke marrë parasysh se të drejtat dhe principet themelore paraprakisht të theksuara janë të pranuar, përkatësisht janë të shprehura në instrumentet rajonale për të drejtat e njerëzve në të drejtën vendore, kushtetuese, të zakonshme dhe legjislative, dhe në marrëveshjet gjyqësore, përkatësisht traditat,

Duke marrë parasysh se rëndësia për gjykatë të pavarur, të paanshëm dhe me ligj të formuar sa i përket mbrojtjes për të drejtat e njerëzve është posaçërisht e shprehur edhe për shkak të faktit se zbatimi i të gjitha të drejtave të tjera përfundon me shpërndarjen përkatëse të drejtë,

Duke marrë parasysh se gjykata e pavarur, e paanshme dhe me ligj e formuar përfaqëson garanci në mbrojtjen e kushtetueshmërisë dhe sundimit të së drejtës,

Duke marrë parasysh se besimi publik në sistemin gjyqësor dhe në autoritetin moral dhe integritetin e gjyqësisë është me rëndësi të madhe në shoqërinë demokratike,

Duke marrë parasysh se me kuptim të dalluar është që gjyqtarët, individualisht dhe së bashku, të respektojnë dhe të miratojnë funksionin gjyqësor si besim publik dhe të synojnë që të përmirësojnë dhe të mbajnë besimin në sistemin gjyqësor,

Duke marrë parasysh se përgjegjësia e përparimit dhe mirëmbajtjes së standarteve të larta të sjelljes së gjyqtarëve në çdo vend është obligim i gjyqësisë së tij,

Duke marrë parasysh se principet themelore të Kombeve të Bashkuara për pavarësinë e gjyqësisë janë të përgaditura mirë për sigurimin dhe përparimin e pavarësisë së gjyqësisë, dhe sidomos janë të dedikuara për shtetet,

Duke marrë parasysh se këto rregulla janë rregulla të arsyeshme dhe të gjitha pjesët e këtij Kodii duhet të lexohen së bashku si një tërësi dhe çdo dispozitë duhet të interpretohet në kontekst të çdo dispozite tjetër dhe në pajtim me të. Ato dispozita duhet të zbatohen në përputhje me Kushtetutën, ligjet dhe konventat e ratifikuara ndërkombëtare në përputhje me Kushtetutën, si dhe përputhje me parime tjera dhe akte nënligjore (rrethana relevante).

Kodi u jep kahje gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë dhe siguron strukturën e rregullimit të sjelljes, të manifestuar në nivel të lartë të përgjegjësisë dhe etikës, që pritet nga bartësit e funksioneve gjyqësore. Rregullat që përfshihen në këtë Kod i tregojnë standartet që caktojnë sjelljen e gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë.

PRINCIPET

Qëllimi i principeve të formuara është krijimi i standarteve të sjelljes etike të gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porot. Ata u japin udhëzime gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porot dhe krijojnë kornizë për rregullimin e sjelljes së tyre. Krahas saj, qëllimi është që të ju ndihmohet anëtarëve të pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv, të juristëve dhe të opinionit më gjërë, që ta kuptojnë më mirë dhe ta pranojnë pushtetin gjyqësor. Këto principe supozojnë se gjyqtarët dhe gjyqtarët porot janë përgjegjës për sjelljen e tyre para institucioneve të formuara për mbajtjen e standarteve gjyqësore, që janë të pavarura

dhe të paanshme, ndërsa qëllimi i tyre është plotësimi, e jo shmangia nga parimet dhe rregullat ligjore të sjelljes që gjyqtarët doemos duhet ti respektojnë.

PAVARËSIA

Princip:

Pavarësia e gjyqësisë është parakusht për sundimin e të drejtës dhe përfaqëson garanci themelore për gjykim të drejtë. Sipas saj, çdo gjyqtarë dhe gjyqtarë porot duhet ta mbështesë dhe të japë shembull për pavarësinë gjyqësore, si për atë sa i përket aspekteve institucionale ashtu edhe për atë sa i përket aspekteve individuale.

Zbatimi:

1.1 Gjyqtari/gjyqtari porot, funksionin gjyqtar e realizon i pavarur, në bazë të vlerësimit personal të fakteve dhe në përputhje me kuptimin e vetëdijshëm të së drejtës dhe zbatimin e ligjit, pavarësisht nga çfarëdo lloji të ndikimeve nga jashtë, parabindjeve, presioneve, kërcënimeve apo përzierjeve, të drejtpërdrejta apo indirekte nga cilado anë apo nga cilado mënyrë.

1.2 Gjyqtari/gjyqtari porot është i pavarur në marrëdhënien me shoqërinë dhe në marrëdhënien me anë konkrete në kontest të caktuar për të cilën duhet të vendos.

1.3 Gjyqtari/gjyqtari porot nuk guxon të jetë nën ndikimin e pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv dhe në çdo rast e mbron pavarësinë e gjykatës nga ndikime dhe presione.

1.4 Gjyqtari/gjyqtari porot i nxit dhe i mbështet mekanizmat mbrojtëse gjatë realizimit të detyrave të gjyqtarit për shkak të mbajtjes dhe përmirësimit të pavarësisë institucionale dhe operative të gjyqësisë.

1.5 Gjyqtari/gjyqtari porot në realizimin e funksionit të gjyqtarit praktikon standarte të larta të sjelljes, me çka përforcohet besimi i opinionit në gjyqësinë, që përfaqëson themelin e pavarësisë gjyqësore dhe sundimin e të drejtës.

PAANËSIA

Princip:

Paanësia është me kuptim esencial për realizimin e funksionit përkatës të gjyqtarit. Gjyqtari/gjyqtari porot është i obliguar që funksionin e gjyqtarit ta realizojë i pavarur, si gjatë marrjes së vendimeve, ashtu edhe në udhëheqjen e procedurave.

Zbatimi:

2.1 Gjyqtari/gjyqtari porot e realizon funksionin e gjyqtarit paanësisht, pa parabindje ose paragjykime.

2.2 Gjyqtari/gjyqtari porot me sjelljen e tij, si në gjykatë, ashtu edhe jashtë nga gjykata, kontribuon për mirëmbajtjen gjegjësisht përmirësimin e besimit tek opinioni, profesionin juridik dhe përmirësimin e besimit tek palët në paanësinë e gjyqtarit dhe të gjyqësisë.

2.3 Gjyqtari/gjyqtari porot kujdeset për përjashtimin kur nuk ka mundësi të merr vendim të paanshëm sipas lëndës së caktuar, gjegjësisht të mos len përshtypje se nuk është në gjendje të gjykojë paanshëm.

2.4 Gjyqtari/gjyqtari porot do të përjashtohet nga pjesëmarrja në cilëndo procedurë ku nuk mund të merr vendim të paanshëm. Procedurat e tilla përfshijnë, por nuk kufizohen në rastet kur:

2.4.1 Gjyqtari/gjyqtari porot ka dedikim esencial, gjegjësisht paragjykime sa i përket ndonjë pale ose ka njohuri personale të fakteve dëshmuese kontestuese në interes të procedurës;

2.4.2 Nëse Gjyqtari/gjyqtari porot është palë e procedurës ose ka marrë pjesë si gjyqtar në procedurën paraprake, avokat, autorizues, obligues ose obligues regresiv ose ka qenë dëshmitar material lidhur me çështjen kontestuese;

2.4.3 Gjyqtari/gjyqtari porot është i obliguar që çdoherë me ligj dhe me praktikë gjyqësore ti njohë rastet e konstatuara dhe të kërkojë përjashtim nga rasti që i është shpërndarë në punë ose i është caktuar të veprojë;

2.5 Gjyqtari/gjyqtari porot gjatë një procedure, gjegjësisht gjatë ndonjë procedure të ardhshme, nuk guxon të japë komente publike ose komente më ndryshe që do të mund të ndikojnë ndaj rezultatit të procedurës ose që do të mund ta ndërprejnë të drejtën e procedurës.

INTEGRITETI

Princip:

Integriteti është atribut i ndershmërisë dhe drejtësisë. Gjyqtari ose gjyqtari porot çdo herë punon ndershëm jo vetëm në realizimin e detyrave zyrtare por edhe në mënyrën që është në interes për realizimin adekuat të funksionit gjyqtar.

Zbatimi:

3.1 Gjyqtari/gjyqtari porot sillet në mënyrë të përsosur në aspektin e çdo mbikqyrësi të arsyeshëm.

3.2 Sjellja e gjyqtarit/gjyqtarit porot si në jetën private ashtu edhe në atë profesionale e konfirmon besimin e njerëzve në integritetin e gjyqësisë.

3.3 Gjyqtari/gjyqtari porot nuk guxon të shfrytëzojë autoritetin e funksionit të gjyqtarit për ti përmbushur interesat private ose interesat e ndonjë anëtari tjetër nga familja ose të kujtqo qoftë tjetër. Gjyqtari/gjyqtari porot nuk guxon të lejojë që të tjerët të kenë përshtypje se dikush është në pozitë të veçantë që në mënyrë të papërshtatshëm të ndikojë ndaj tij gjatë realizimit të detyrave të gjyqtarit.

3.4 Gjyqtari/gjyqtari porot, anëtarët e familjes së tij ose persona që jetojnë në të njëjtën amvisëri, nuk guxojnë të pranojnë, e as të kërkojnë dhurata, huazime, as edhe shërbime tjera nga palë ose nga persona që kanë ose mund të kenë interes në lëndë të caktuar ose dërgim të produkteve ose shërbime për gjykatën, në lidhje me diçka që gjyqtari mund ta bëjë, gjegjësisht ta kalojë që ta bëjë lidhur me realizimin e funksionit gjyqtar, përveç se në përjashtim të dhuratave protokolare të fituara në vizita zyrtare, pritje ose festime.

3.4.1. Ndalimi për pranimin e dhuratave ka të bëjë me dhurata materiale ose interes jomaterial.

3.4.2. Nën dhuratë materiale nënkuptohet para, letra me vlerë, gjëra, të drejta dhe shërbime tjera të ofruara nga gjyqtari ose gjyqtari porot ose miq të afërt të tij për marrjen përsipër gjegjësisht mos marrjen përsipër të ndonjë veprimi të caktuar gjatë realizimit të funksionit të gjyqtarit.

3.4.3. Nën interes jomaterial nënkuptohet çdo interes i gjyqtarit/gjyqtarit porot, që nuk sigurohet me pagesë, me qëllim që të veprojë ose të përmbahet nga veprimi në përputhje me detyrat e tij ose ti realizojë kompetencat e tij në kundërshtim me detyrat zyrtare dhe dispozitat e këtij Kodi. Interesi jomaterial poashtu nënkupton zbritje në çmime dhe shërbime për shkak të funksionit të gjyqtarit/gjyqtarit porot, si dhe këshillë profesionale pa pagesë të gjyqtari/gjyqtarit porot.

3.4.4. Nën dhuratë protokolare nënkuptohen dhurata të pranuar nga ana e personave zyrtar ose nga ana e organizatave ndërkombëtare, që janë dhënë gjatë vizitave, pritjeve, gostive, ose festimeve, vlera e të cilave nuk tejkalon 3000 denarë në vitin e dhënë.

3.4.5. Kryetari i gjykatës udhëheq Regjistër me informata për dhurata protokolare ku fut: llojin e dhuratës, vlerën e dhuratës, dhuruesin, pranuesin, kohën dhe vendin e pranimit. Informatat nga Regjistri i dhuratave protokale, kryetari i gjykatës i dërgon në Trupin Këshillëdhënës të etikës gjyqësore.

3.5 Gjyqtari/gjyqtari porot i njeh interesat e tij dhe interesat financiale të anëtarëve të familjes së tij.

MIRËSJELLJA

Princip:

Mirësjellja dhe sjellja kulturore – përkatëse e gjyqtarit/gjyqtarit porot janë me kuptim esencial për realizimin e të gjitha aktiviteteve të funksionit të gjyqtarit..

Zbatimi:

4.1 Gjyqtari/gjyqtari porot e shmang sjelljen jo të mirë dhe çdo gjë që përmban sjellje jo të mirë, gjatë realizimit të aktiviteteve si gjyqtar.

4.2 Gjyqtari/gjyqtari porot si objekt i mbikëqyrjes së vazhdueshme nga ana e publikut, lirshëm dhe vullnetarisht pranon kufizime personale, që qytetari i zakonshëm mund ti konstatojë si ngarkesë të madhe. Gjyqtari/gjyqtari porot sillet në atë mënyrë që është në përputhje me dinjitetin dhe krenarinë e funksionit të gjyqtarit.

4.3. Gjyqtari/gjyqtari porot në marrëdhëniet e tij personale me anëtarë individual të profesionit juridik që rregullisht punojnë në gjykatën e tij, shmang situata që do të çonin në dyshimin e ekzistimit të dedikimit, gjegjësisht anësisë.

4.4 Gjyqtari/gjyqtari porot nuk guxon të lejon që vendbanimi i tij të shfrytëzohet në kundërshtim me principet e këtij Kodi.

4.5 Gjyqtari/gjyqtari porot, si edhe çdo person tjetër, ka të drejtë lirinë e të shprehurit, besimin, shoqërimin dhe grumbullimin, por gjatë realizimit të këtyre të drejtave, çdoherë sillet në atë mënyrë me të cilën rruhen dinjiteti dhe krenaria e funksionit të gjyqtarit dhe paanësia dhe pavarësia e gjyqësorit.

4.6 Gjyqtari/gjyqtari porot nuk guxon të lejon që çështjet familjare, sociale dhe çështje të tjera të ndikojnë në mënyrë të papërshtatshme ndaj sjelljes gjatë realizimit të funksionit të gjyqtarit.

4.7 Gjyqtari/gjyqtari porot nuk guxon që informatat e besueshme që i ka fituar gjatë realizimit të funksionit të gjyqtarit ti shfrytëzon, gjegjësisht ti zbulon për çfarëdo lloj qëllimi lidhur me detyrat e gjyqtarit.

4.8 Me kusht që me përgjegjësi ti realizojnë detyrat e gjyqtarit, ndërsa në rastet kur kërkohet, dhe me pajtueshmëri nga me ligj organ i caktuar, gjyqtari/gjyqtari porot mund të:

4.8.1 të shënon, të ligjëron, të mban mësim dhe të marrë pjesë në aktivitete lidhur me ligjin, sistemin juridik, ndarjen e të drejtës dhe çështje të tjera;

4.8.2 të paraqitet në shqyrtim publik para trupit zyrtar lidhur me çështje që kanë të bëjnë me të drejtën, sistemin juridik, ndarjen e të drejtës dhe çështje të tjera;

4.8.3 të jetë anëtarë i trupit zyrtar, ose i ndonjë komisioni tjetër qeveritar, bordi ose trupi këshillëdhënës, nëse anëtarësia e tillë nuk është konsekuente me paanësinë dhe politikën neutrale; ose

4.8.4 të merren me aktivitete tjera nëse aktivitetet e tilla nuk vijnë në shprehje negativisht në dinjitetin dhe krenarinë e funksionit të gjyqtarit, gjegjësisht nëse nuk e pengojnë realizimin e detyrave si gjyqtarë;

4.8.5 gjyqtari/gjyqtari porot nuk guxon të merret me dhënien e ndihmës juridike përdërisa e realizon funksionin si gjyqtar;

4.8.6 gjyqtari/gjyqtari porot mund të formon, gjegjësisht të përfshihet në shoqatat ose të marrë pjesë në organizata tjera që i përfaqësojnë interesat e gjyqtarëve ose gjyqtarëve porot;

4.8.7 gjyqtari/gjyqtari porot nuk guxon të jetë anëtarë i këshillit administrativ, këshillit mbikqyrës, gjegjësisht komisionit të revizionit të cilësdo kompani në përputhje me të drejtën tregtare, ose kooperativës ose fondacionit që bën punë afariste, të posedon aksione ose të jetë në ndonjë formë tjetër të marrëdhënies kapitale me shoqatën tregtare nëse ajo shkakton ndeshje të kompetencave të interesave me realizimin e funksionit të gjyqtarit si funksion publik ose të udhëheq ndërrmarje afariste, i pavarur ose së bashku me persona të tjerë. Këto dispozita nuk vlejné për gjyqtarët/gjyqtarët porot në pension.

BARAZIA

Princip:

Sigurimi i barazisë në procedurën për të gjithë në gjykatat është me kuptim esencial për realizimin e funksionit të gjyqtarit.

Zbatimi:

5.1 Gjyqtari/gjyqtari porot është i vetëdijsëm dhe e kupton llojllojshmërinë në shoqërinë dhe dallimet që rrjedhin nga burime të ndryshme, duke i përfshirë, por jo

duke u kufizuar në rasën, ngjyrën, gjininë, fenë, prejardhjen kombëtare, nevojat e veçanta, moshën, gjendjen e martesës, orientimin seksual, situatën sociale dhe ekonomike dhe të ngjashme.

5.2 Gjyqtari/gjyqtari porot nuk guxon gjatë realizimit të detyrave të tij gjyqësore, me fjalë ose me sjelljen të tregojë anshmëri ndaj cilitdo qoftë personi ose grupi ndaj bazave irelevante.

5.3 Gjyqtari/gjyqtari porot e realizon funksionin e gjyqtarit në bazë të ligjit, në mënyrë të drejtë duke u orientuar kah të gjithë personat, përkatësisht kah palët, dëshmitarët, avokatët, personelit gjyqësor dhe kolegëve gjyqësor, pa bërë dallime ndaj bazat irelevante, si joesenciale në realizimin përkatës të detyrave.

5.4 Gjyqtari porot do të kërkojë nga avokatët në procedurat e gjykatës të përmbahen nga tregimi, me fjalë ose me sjellje, përkushtim, përkatësisht paragjykime ndaj bazave irelevante, përveç nëse ajo është e drejtë relevante sa i përket çështjes që është lëndë e procedurës, përkatësisht, që mund të jetë lëndë e përfaqësimit juridik ligjor.

5.5 Gjyqtari/gjyqtari nuk mund të jetë anëtarë i asnjë organizate që realizon diskriminim.

PROFESIONALIZMI DHE NDËRGJEGJSHMËRIA

Princip:

Profesionalizmi dhe ndërgjegjshmëria janë parakusht për realizimin përkatës të funksionit gjyqësor.

Zbatimi:

6.1 Detyrat e gjyqtarëve të gjyqtarit/gjyqtarit porot kanë prioritet para të gjitha aktiviteteve tjera.

6.2 Gjyqtari/gjyqtari porot punën profesionale të tij, ia përkushton realizimit të detyrave të gjyqtarëve, që përfshijnë jo vetëm realizimin e funksionit dhe detyrat e gjyqtarit në gjykatë dhe në sjelljen e vendimeve, por edhe detyra tjera përkatëse të pozitës së gjyqtarit.

6.3 Gjyqtari/gjyqtari porot tenton të përvetësojë kompetencën e tij profesionale, diturinë dhe shkathtësitë, në bazë të trajnimit dhe arsimimit të vazhdueshëm profesional.

6.4 Gjyqtari/gjyqtari porot informohet për ndryshimet përkatëse të së drejtës ndërkombëtare, duke i përfshirë edhe konventat ndërkombëtare dhe instrumentet tjera me të cilat garantohen të drejtat e njeriut.

6.5 Gjyqtari/gjyqtari porot e realizon funksionin e gjyqtarit në mënyrë të zellshme, efikase, të drejtë dhe me azhurnim të arsyeshëm.

6.6 Gjyqtari/gjyqtari porot në procedurën në gjykatë është i durueshëm, dinjitoz dhe i sjellshëm në lidhje me palët, porotët, dëshmitarët, avokatët dhe personat tjerë me të

cilët bashkëpunon zyrtarisht. Gjyqtari do të kërkojë sjelljen e ngjashme edhe nga ana e përfaqësuesve juridik, personelit gjyqësor, gjyqtarëve porot dhe nga persona të tjerë që janë në ndikim, kompetencë, përkatësisht kontrollin e gjyqtarit.

6.7 Gjyqtari/gjyqtari porot nuk guxon të lëshohet në sjelljen që nuk ka të bëjë me realizimin dinjitoz të detyrave të gjyqtarit.

NDESHJA E INTERESAVE, KORRUPSIONI DHE THYERJA E PRINCIPEVE

7.1 Çdo thyerje e principeve të Kodit do të vlerësohet si thyerje e këtij Kodi. Çdo gjyqtar/gjyqtar porot ka për detyrë ti ketë parasysh dhe të mbrohet nga rastet që joshen nga ndeshja e interesave dhe korrupsioni. Nëse gjyqtari/gjyqtari porot konstaton se ndonjë sjellje e caktuar do të thyente principet e këtij Kodi, ai mund të parashtrojë kërkesë për mendim këshillëdhënës ose këshillë deri në Trupin këshillëdhënës të etikës pranë Shoqatës së gjyqtarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

7.2. Gjyqtari ka për detyrë që në realizimin e funksionit të gjyqtarit dhe aktivitete jashtë gjykatës të zhvillon standarte të sjelljes që kontribuojnë në rruajtjen e autoritetit dhe dinjitetin e gjykatës dhe profesionit të gjyqtarit.

7.3. Në realizimin e funksionit kryetar të gjykatës ose kryetar të sektorit, gjyqtari nuk guxon të krijohet amtosferë e konfliktit ndërmjet interesit publik dhe interesit privat, në realizimin e funksionit të tij.

7.4. Gjyqtari/gjyqtari porot nuk guxon të realizon çfarëdo detyrë publike ose private, me pagesë ose pa pagesë, që janë në kundërshtim me funksionin e gjyqtarit ose gjyqtarit porot.

7.5. Gjyqtari/gjyqtari porot nuk duhet të lejon që marrëdhëniet familjare, të ndikojnë në punën e tij dhe në vendimmarrjen gjatë realizimit të funksionit të tij.

7.6. Gjyqtari/gjyqtari porot nuk mund të shfrytëzon dinjitetin e profesionit gjyqësor në realizimin ose avancimin e interesave të tij private, interesave të anëtarëve të familjes së tij ose çfarëdo lloj interesi tjetër.

7.7. Gjyqtari/gjyqtari porot nuk guxon që tu mundëson anëtarëve të familjes së tij, të punësuarve në gjykatën, ose cilitdo personi tjetër, të pranojë dhuratë, hua ose shërbim për diçka që do të ndikonte në ushtrimin e funksionit si gjyqtar dhe në sjelljen e vendimit.

7.8. Gjyqtari/gjyqtari porot nuk guxon, përveç nëse atë nuk e parashohin rregullat e procedurës, të vepron ose të procedon në cilëndo cilësi në lëndën ku ka vepruar para ushtrimit të funksionit të tij si gjyqtar ose detyrat e gjyqtarit porot, si dhe në rastet që kanë të bëjnë me lëndën.

ZBATIMI

8.1 Zbatimi i principeve dhe sigurimi i respektimit të tyre nga ana e gjyqtarëve/gjyqtarëve porot janë me kuptim esencial të arritjes së qëllimeve efektive të këtij Kodi.

8.2 Sipas natyrës së funksionit të gjyqtarit, për sjelljen e tyre gjyqtarët/gjyqtarët porot janë përgjegjës në përputhje me ligjin, ndërsa mendim këshillëdhënës ose këshillë sa i përket zbatimit të principeve dhe sigurimin e respektimit të tyre nga ana e gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porot, jep trupi këshillëdhënës që formohet për zbatimin e këtij Kodi.

8.3 Çështja e trupit këshillëdhënës dhe procedurat e vendosura për zbatimin e këtij Kodi janë transparente me qëllim që të kontribuojnë ndaj përforcimit të besimit të publiku në gjyqësinë.

8.4 Zbatimi i këtij Kodi, e ka parasysh nevojën ligjore të gjyqtarit/gjyqtarit porot, që ti sigurohet mbrojtja nga akuza shqetësuese, përkatësisht akuza të papërshtatshme, si dhe të jepet këshillë për sjellje të caktuar në procedurë përkatëse.

TRUPI KËSHILLËDHËNËS I ETIKËS GJYQËSORE

9. Për zbatimin konsekuent të principeve të Kodit të etikës gjyqësore, Shoqata e gjyqtarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut formon trup këshillëdhënës, që me kërkesë të gjyqtarit, gjyqtarit porot, kryetarit të gjykatës, mbledhje të gjykatës dhe Shoqatës së gjyqtarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut (degët) shpreh mendime këshillëdhënëse dhe këshilla sa i përket një ose më shumë çështjeve të lidhura me sjelljen etike të gjyqtarit/gjyqtarit porot, gjegjësisht realizimin përkatës të detyrave të gjyqtarëve dhe shmangien e ndeshjes së interesave të gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porot në jetën private dhe në realizimin e funksionit të gjyqtarit.

9.1 Mendimet dhe këshillat nga trupi këshillëdhënës kanë kuptim të rëndësishëm preventiv. Ato shprehin sjellje që përfaqësojnë cenimin e principeve të Kodit të gjyqtarëve.

9.2 Trupi këshillëdhënës vepron në suaza të Shoqatës së gjyqtarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe përbëhet nga kryetari dhe 6 anëtarë.

9.3 Anëtarët e trupit këshillëdhënës i përzgjedh Këshilli drejtues i Shoqatës së gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porot të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të degëve të Shoqatës së gjyqtarëve, me mandat prej 2 (dy) vjet.

Anëtarët e Trupit këshillëdhënës të etikës së gjyqtarëve përzgjidhen në mënyrën në vijim: një gjyqtar i Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, një gjyqtar i Gjykatës së lartë administrative ose Gjykatës administrative, nga një gjyqtarë i çdo rajoni të apelacionit, që gëzojnë besimin tek gjyqtarët në bazë të integritetit dhe dinjitetit të tij personal në realizimin e funksionit të gjyqtarit dhe një gjyqtar nga rradhët

e gjyqtarëve porot. Kryetari i trupit këshillëdhënës përzgjidhet nga rradhët e anëtarëve të trupit këshillëdhënës.

Anëtarët e trupit këshillëdhënës gëzojnë imunitet dhe nuk mund të jenë përgjegjës ose kundër tyre të ngriten procedura disiplinore për shkak të votimit, mendimit të shprehur ose veprimtimit si anëtarë të trupit këshillëdhënës.

Anëtarët e trupit këshillëdhënës punojnë pa kompensim.

Trupi këshillëdhënës i etikës së gjyqtarëve dërgon raport vjetor për aktivitetet e tij në Këshillin drejtues të Shoqatës së gjyqtarëve dhe në Mbledhjen e përgjithshme të Gjykatës supreme.

9.4 Kërkesa për mendim këshillëdhënës ose këshillë nga gjyqtari, gjyqtari porot, kryetari i gjykatës, mbledhja e gjyqtarëve dhe Shoqata e gjyqtarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut (degët), bëhet në formë të shkruar, ndërsa trupi këshillëdhënës do të përgjigjet me shkrim në afat jo më gjatë se 15 ditë, llogaritur nga dita e pranimit të kërkesës, në bazë të fakteve dhe rrethanave konkrete. Në qoftë se disa nga faktet respektivisht rrethanat që janë dhënë në kërkesën nuk janë mjaft të sqaruara, që të mund ti mundësojnë trupit këshillëdhënës të jep mendim këshillëdhënës ose këshillë, mund të kërkohen informacione plotësuese nga parashtuesi i mendimit të kërkuar. Trupi këshillëdhënës nuk do të jep mendim e as këshillë në qoftë se informacionet plotësuese nuk mjaftojnë ose nëse të njëjtat nuk dërgohen.

9.5 Kërkesat për mendime këshillëdhënëse, këshillat dhe mendimet këshillëdhënëse të lëshuara nga ana e trupit këshillëdhënës, si dhe faktet dhe rrethanat në të cilat janë formuar, janë sekrete.

9.6 Trupi këshillëdhënës i publikon mendimet e tij këshillëdhënës në ueb faqen e Shoqatës së gjyqtarëve dhe në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe faktet dhe rrethanat në bazë të së cilave janë formuar, me anonimizimin përkatës të personave, vendeve dhe të dhënave tjera që do të mund të çonin në identifikim. Mbledhjet e trupit këshillëdhënës janë sekrete. Publikimi i mendimeve të redaktuara (anonimizuara) të trupit këshillëdhënës janë të disponueshëm deri te të gjithë gjyqtarët me qëllim që tu sigurojnë kahje gjyqtarëve tjerë që ballafaqohen me çështje të ngjashme.

Publikimi i mendimeve dhe këshillave juridike sa i përket çështjeve të caktuara lidhur me realizimin e funksionit të gjyqtarit, pengimin e konfliktit të interesave të gjyqtarëve/gjyqtarëve porot, mënyrën e disponimit me dhuratat protokolare të fituara në vizitat zyrtare, pritjet dhe solemnitetet, si dhe ndalimi i pranim/dhënie së dhuratave gjyqtarit dhe gjyqtarit porot dërgohen personalisht, në mënyrë elektronike ose përmes postës deri te parashtuesi i kërkesës për dhënie të këshillës.

DISPOZITA TË VAZHDUESHME DHE PËRFUNDIMTARE

Kodi i etikës së gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porot hyn në fuqi menjëherë pas publikimit të tij në ueb faqen e Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në afat prej 3 (tre) muaj pas publikimit të Kodit, Këshilli drejtues i Shoqatës së gjyqtarëve do të përzgjedh përbërje të re të trupit këshillëdhënës.

Kodi i etikës së gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porot është sjellë në bazë të nenit 10 dhe nenit 35 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të gjykatave ("Gazeta zyrtare e RMV", nr.96 nga 17.05.2019).

**GJYKATA SUPREME E
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
MBLEDHJA E PËRGJITHSHME**